Nr. 1183/5 prot.,

Tiranë, më 27.05.2025

**VENDIM**
**Nr. 28, datë 27.05.2025**

**PËR**
**"MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE NË NEVOJË, QË PËRFITOJNË BURSË PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016 *"Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë*", i ndryshuar, Bordi i Administrimit pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.329/28, datë 25.04.2025 *"Ridërgohen për miratim listat e studentëve në nevojë, të cilët përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, shtesë në fazën e parë të aplikimeve"*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën e 3 (tre) studentëve në nevojë, që përfitojnë bursë për vitin akademik 2024-2025, shtesë në fazën e parë të aplikimeve, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total është 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETAR**
**ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

| | | |
|---|---|---|
| **MONIKA FIDA** | **VERA OSTRENI** | **ALBANA GJINOPULLI** |
| **ANIS THODHORJANI** | **ALTINA XHAFERI** | **ENDRIT YZEIRAJ** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

**ADMINISTRATORI**

Nr. 329/28 Prot.

Tiranë, më 25.04.2025

**Lënda:** Ridërgohen për miratim listat e studentëve në nevojë, të cilët përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, shtesë në fazën e parë të aplikimeve.

## BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

E nderuar Kryetare,

Të nderuar Anëtarë të Bordit të Administrimit,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016, "*Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë*", i ndryshuar, studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kanë aplikuar për përfitimin e bursës studentore sipas kriterit ekonomik, pranë komisioneve të ngritura në çdo fakultet.

Fakulteti i Mjekësisë Dentare ka përcjellë listën me tre studentë, shtesë në fazën e parë, të cilët plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës studentore për vitin akademik 2024-2025.

Kriteret që plotësojnë studentët për të përfituar bursën studentore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Fakultetet | Studentë, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike | Studentë, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar | Numri i studentëve që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës. | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| FMD | 1 | 1 | 1 | 3 |
| **TOTAL** | **1** | **1** | **1** | **3** |

Efekti financiar për këta tre studentë është llogaritur në tabelën e mëposhtme:

| **Fakultetet** | **Studentët përfitues** | **Vlera e bursës mujore** | **Shuma totale e bursave për 9 muaj** |
|---|---|---|---|
| FMD | 3 | 10,000 | 270,000 |
| **TOTAL** | **3** | **10,000** | **270,000** |

Efekti financiar është 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, llogaritur për 9 muaj dhe do të përballohet plotësisht nga fondet grant të buxhetit të shtetit të shpërndara me grantin e vitit 2025.

Për sa më sipër, i propozojmë Bordit të Administrimit, miratimin e listës me tre studentë në nevojë, të cilët studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe në një program studimi të integruar të integruar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe përfitojnë bursë studentore për vitin akademik 2024-2025, shtesë në fazën e parë të aplikimeve.

Listat analitike të studentëve ndodhen në shkresat bashkëlidhur këtij materiali:

- Shkresë nr. 666/23 prot., datë 19.03.2025, protokolluar me Tonën me nr. 329/14 prot, datë 19.03.2025, e Fakultetit të Mjekësisë Dentare.

- Shkresë nr. 666/46 prot., datë 24.04.2025, protokolluar me Tonën me nr. 329/27 prot, datë 24.04.2025, e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, ridërguar për miratim nga fakulteti pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e komisionit.

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,*

**ADMINISTRATOR**
**ARLIND BROCI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I MJEKËSISË - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
REKTORATI
Nr. 229/14 Prot.
19. 03. 2025

Nr ______ Prot

Tiranë më ___/___/2025

**LËNDA :** Dërgohet "Lista e Përfituesve për Bursë" për vitin akademik 2024-2025, faza nr.1.

**ADMINISTRATORIT TE UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË , TIRANË**

Në vijim të proçedurës për përfitim Burse nga studentët aplikues për vitin akademik 2024-2025, po Ju dërgojmë Proçes-Verbalin Nr.666/23 Prot., Datë 19.03.2025, Proçes-Verbalin Nr.666/24 Prot., Datë 19.03.2025 dhe listën e përfituesve Nr. 666/25 Datë 19.03.2025 për Fazën e parë.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpuninmin,**

**ADMINISTRATOR FMD**

**Oltian SHERA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr ______ Prot

Tiranë më ___/___/2025

# PROCES VERBAL

## Mbi Rishqyrtimin e dokumentacionit per perfitim Burse 2024-2025

Date ________

Në vijim të Urdhrit Nr. 23 prot, datë 01.11.2024 "Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e dokumentacionit të studentëve në ciklin e parë bachelor, në programin e integruar të studimeve për përfitim burse, për vitin akademik 2024-2025", si dhe referuar shkresës Tuaj, **Nr. 666 Prot., datë 01.11.2024**, komisioni përkatës u mblodh për shqyrtimin e dokumentacionit të ridorëzuar nga studenti Serxho Tanushi.

Në fazen e parë studenti Serxho Tanushi nuk ishte fitues i Bursës pasi sipas Procesverbalit 666/2 datë 11.12.2024 studenti kishte dorezuar një shkresë nga Ministria e Mbrojtjes "Për përjashtimin nga Tarifa dhe Trajtim me bursë të plotë" e cila ishte fotokopje.

Në datë 05.03.2025 u informuam përmes një emaili nga Rektorati UMT për shkresën origjinale të ardhur nga Ministria e Mbrojtjes me Nr 6485/1 Prot datë 15.11.2024, e cila konfirmon që Studenti Serxho Tanushi është përfitues i Bursës për vitin akademik 2024-2025.

Nga rikontrolli i dokumentacionit të dorëzuar nga studentët rezultoi si më poshtë:

**1.Serxho Tanushi, viti 2**

Studenti ka dorëzuar:

-Kartën e identitetit

-Certifikatë familjare e 3 muajve të fundit

-Certifikate Vdekje, Klodian Tanushi (Babai) 24.08.2024

-Shkresë nga Ministria e Mbrojtjes Nr 6485/1 Prot datë 15.11.2024, per perjashtimin nga Tarifa dhe Trajtim me burse te plote, (email i dates 05.03.2025 nga Rektorati UMT)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Konkluzioni: *Studenti është përfitues* i bursës sipas kriterit: **''Studentet te cilet jane femije te punonjesve te policise se shtetit, te Gardes se Republikes, te Sherbimit per ceshtjet e brendshme dhe ankesat, per sherbimin te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, te forcave te armatosura, te sherbimit informativ shteteror, dhe te policise se burgjeve, qe kan humbur jeten ne krye dhe per shkak te detyres''**

Komisioni:

Lela Berdica

Eni Cara

Genci Çiko

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**
**FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE**

Nr ______ Prot

Tiranë më ______ /2025

# PROCES VERBAL
## Mbi Rishqyrtimin e dokumentacionit per perfitim Burse 2024-2025
**Date** ______

Në vijim të Urdhrit Nr. 23 prot, datë 01.11.2024 "Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e dokumentacionit të studentëve në ciklin e parë bachelor, në programin e integruar të studimeve për përfitim burse, për vitin akademik 2024-2025", si dhe referuar shkresës Tuaj, **Nr. 666 Prot., datë 01.11.2024**, komisioni përkatës u mblodh për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët.

Studentja Arba Lipo ka aplikuar per perfitimin e Burses me date 12.11.2024, ku ka dorezuar si dokumentacion vetem:

-Kartën e identitetit
-Cerfitikatë familjare e 3 muajve të fundit
-Vërtetim për përfitim ndihmë ekonomike ( E-Albania)

Studentja ka dorezuar dokumentacionin Vërtetim për përfitim ndihmë ekonomike nga njësia bashkiake Pogradec, Nr 1533 Prot. dt 18.11.2024, ne nje moment te dyte me date 18.11.2024 dhe nuk eshte shqyrtuar nga komisioni. Prandaj:

**1. Arba Lipo, viti 2**
Studenti ka dorëzuar:
-Kartën e identitetit
-Cerfitikatë familjare e 3 muajve të fundit
-Vërtetim për përfitim ndihmë ekonomike nga njësia bashkiake Pogradec, Nr 1533 Prot. dt 18.11.2024

**Konkluzioni:** ***Studenti është përfitues*** i tarifës sipas kriterit : **"Student, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike"**

**Komisioni:**

Lela Berdica
Eni Cara
Genci Çiko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr ______ Prot

Tiranë më ______ /2025

**Lënda :** Lista e studentëve që përfitojnë Burse për vitin akademik 2024-2025, Faza e 1

Në mbështetje të proces verbalit nr.66/23/24 Prot, datë 19.03.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për Burse 2024-2025, studentët përfitues, janë si më poshtë:

| **Nr** | **Emër Mbiemër/ kriteri** | **Dega në të cilën studion** | **Viti i shkollimit** |
|---|---|---|---|
| | **''Studentet te cilet jane femije te punonjesve te policise se shtetit, te Gardes se Republikes, te Sherbimit per ceshtjet e brendshme dhe ankesat, per sherbimin te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, te forcave te armatosura, te sherbimit informativ shteteror, dhe te policise se burgjeve, qe kan humbur jeten ne krye dhe per shkak te detyres''** | | |
| 1 | Serxho Tanushi | Stomatologji | 4 |
| | **"Student, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike"** | | |
| 1 | Arba Lipo | Teknike Dentare | 2 |

**Efekti Financiar = 9 muaj x 2 studente x 10 000 leke = 180 000 leke**

**Komisioni**

Lela Berdica

Eni Cara

Genci Ciko

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI
Nr. 329/27 Prot.
Dt. 24/04/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**
**FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE**

Nr 666/46 Prot

Tiranë më 24/04/2025

**LËNDA :** Ridërgohet "Lista e Përfituesve për Bursë" për vitin akademik 2024-2025, faza nr.1&4.

**ADMINISTRATORIT TE UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË , TIRANË**

Sipas kërkesës Tuaj në emailin e datës 22.04.2025, po Ju dërgojmë Proçes-Verbalin Nr.666/42 Prot., Datë 24.04.2025, listën e përfituesve Nr. 666/43 Datë 24.04.2025 për Fazën e katert dhe Proçes-Verbalin Nr.666/44 Prot., Datë 24.04.2025, listën e përfituesve Nr. 666/45 Datë 24.04.2025.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpuninmin,**

**ADMINISTRATOR FMD**

**Oltian SHERA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 666/42 Prot

Tiranë më 24/04/2025

# PROCES VERBAL

## Mbi Rishqyrtimin e dokumentacionit per perfitim Burse 2024-2025

Date 24.04.2025

Në vijim të Urdhrit Nr. 23 prot, datë 01.11.2024 "Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e dokumentacionit të studentëve në ciklin e parë bachelor, në programin e integruar të studimeve për përfitim burse, për vitin akademik 2024-2025", si dhe referuar shkresës Tuaj, **Nr. 666 Prot., datë 01.11.2024**, komisioni përkatës u mblodh për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit konstatuam që studentja Maria Rrushi është përfituese e Bursës që nga faza e 1.

Efekti financiar fillon nga fillimi i vitit Akademik.

**1. Maria Rrushi, viti 4**

Studenti ka dorëzuar:

-Kartën e identitetit

-Vertetim lëshuar nga KMCAP ( noterizuar).

-Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar origjinal, date 01.11.2024, bashkia Elbasan.

**Konkluzioni:** ***Studenti është përfitues*** i Bursës sipas kriterit : **"Student, me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar"**

**Komisioni:**

Lela Berdica

Eni Cara

Genci Çiko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 666/43 Prot

Tiranë më 24/04/2025

**Lënda :** Lista e studentëve që përfitojnë Bursë për vitin akademik 2024-2025, Faza nr. 1

Në mbështetje të proces verbalit nr. 666/42 Prot. datë 24.04.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për përfitimin e Bursës 2024-2025, studentët përfitues për Fazën nr. 1, janë si më poshtë:

| Nr | Emër Mbiemër/ kriteri | Dega në të cilën studion | Viti i shkollimit |
|---|---|---|---|
| | **"Student, me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga KMCAP, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar"** | | |
| | **Master ne Stomatologji** | | |
| 1 | Maria Rrushi | Stomatologji | 4 |

**Komisioni:**

Lela Berdica

Eni Cara

Genci Çiko

erkesë!

**rigo Jaupi** <marigo.jaupi@umed.edu.al>
Elfrida, Oltian, Arlind

Tue, Apr 22, 12:40 PM (3 days ago)

rshëndetje!

procesverbalet nr.666/29, /30, /33, /34, në lidhje me listat e studentëve në nevojë të cilët kanë aplikuar për të përfituar bursë pranë FMD-së, të cilat janë dërguar për miratim pranë Bordit të Administrimit të UMT-së, rezulton
tar i komisionit Genci Çiko nuk ka nënshkruar procesverablet.

ridërgohet edhe njëherë dokumentacioni në fjalë i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit në protokollin e Rektoratit sa më shpejt.

eminderit!


**Marigo JAUPI**

**Drejtor**
**Drejtoria Ekonomike**

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

marigo.jaupi@umed.edu.al

**lresa postare**: Rruga e Dibrës, Nr. 369,
Hyrja nr. 1, 1012 - Tiranë - Shqipëri

w.umed.edu.al



*do për ambientin përpara se të printosh këtë email.*

*acioni i transmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për cionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për sin. Çdo rishikim, transmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga nat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar,është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë th, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të transmetuar në kompjuterin tuaj. k pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.*